



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 79/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit nr. 485/2013 të datës 26.07.2013, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos emërimit të Zyrtarit Blerim Muji në Komisionin Komunal Zgjedhor në Gjilan për zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 05.08.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datën 02.08.2013, nga subjekti politik LDK dega në Gjilan, më të cilën pretendohet se KQZ me vendimin nr. 485/2013 i datës 26.07.2013, ia ka mohuar të drejtën zyrtarit të nominuar nga subjekti politik LDK, për të u emëruar si Zyrtar i Komisionit Komunal Zgjedhor në Gjilan.

Parashtruesi i ankesës konsideron se vendimi i lartpërmendur është i padrejtë dhe në kundërshtim me çdo normë juridike.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar

Meqenëse pretendimet ankimore nga parashtruesi i ankesës janë bërë për shkak se i nominuari i subjektit politik LDK nuk është emëruar nga KQZ-ja, si Zyrtar në Komisionin Komunal Zgjedhor në Gjilan, për zgjedhjet e 03.11.2013. PZAP-i duke u bazuar në nenin 63.6 të LZP-së, se vendimi i KQZ-së nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj dhe neni 122.1 pikat a), b), c), d) e) dhe f) Apelimet Zgjedhore të LZP-së, konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë në kompetencë të PZAP-it, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja

A nr. 79/2013 më datën 05.08.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

